



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 104

NR. VENDIMI 104

NR. 944/104 AKTI
Nr 6612 VENDIMI
Date 23.11.2020
Date 22.01.2021

VENDIM

MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR : MARIANA SHEGANI (DEDI)

me cilësinë e gjyqtarit të vetëm, sot më date 22.01.2021, mori në shqyrtim kërkesën që i perket :

KËRKUES: *** në cilësinë e presidentes së Shoqatës në krijim e sipër ***, me seli në adresën ***.

OBJEKTI: Regjistrimi si person juridik të Shoqatës ***, ose shkurtimisht ***.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar; Ligji nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi, aktet shkresore bashkangjitur kërkeses, për Regjistrimin si person juridik të Shoqatës ***, ose shkurtimisht *** në Regjistrin e Organizatave Jo Fitimprurëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

VEREN

Me kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkesja ***, në cilësinë e Presidentes së Shoqatës ***, kërkon regjistrimin si person juridik të Shoqatës ***ose shkurtimisht ***, bazuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

Nga aktet e paraqitura rezulton se më datë 19.11.2020 themeluesit Themeluesit e Shoqatës janë: -*** shoqëri e regjistruar që vepron sipas legjislacionit të Republikës së ***, me nr. unik identifikues ***, seli ***.

Sipas Certifikates Nr ***date ***, leshuar nga Gjykata Themelore Prishtine , rezulton se : Operatori ekonomik ***me numer biznesi ***,nuk eshte shpallur i falimentuar ose insolvent gjate dy viteve te kaluara dhe nuk eshte iniciuar procedura e falimentimit perkatesisht e likujdimit”

-2. Shoqeria *. shoqëri e regjistruar që vepron sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë me nr. NUIS *** seli ***.**

Themeluesit e organizates kanë deklaruar me vullnetin e tyre para noterit për themelimin e Shoqatës * shkurtimisht ***.**

Në hyrje të Aktit të themelimit përcaktohet se Shoqata është një organizatë e pavarur, joqeveritare, jopartiake, jofitimprurëse.

Objekti i veprimtarisë së organizatës do të jetë :

Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, në përputhje me Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tij si dhe në përputhje me licensën përkatëse.

Agjencia ka si qëllim mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to dhe konkretisht administrimin kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramit, interesat e të cilëve Agjencia përfaqëson dhe me të cilët do të lidhë kontratat përkatëse.

Objekti i mesipërm do të përfshijë: dhënien për përdoruesit, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi; të mbledhë shpërblimin për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura; të shpëndaje, në bazë të rregullave të shpërndarjes, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit në mënyrë të drejtë dhe të përpjestuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura; të përfaqësojë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve ata administrojnë, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejnë çdo veprim tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ato; të kryejë çdo veprim tjetër, në përputhje me tagrat e tyre ligjore dhe të organeve të veta vendimmarrëse, për kompetencat e marra nga mbajtësit e të drejtave;

të hartojë metodologji të negociueshme për përcaktimin e nivelit të tarifave që subjektet përdoruese duhet të paguajnë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; të realizojë në emër të autorit ose të mbajtësit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të ose në bazë të kontratës së reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme marrëveshjet e përgjithshme me organizatorët e shfaqjeve, me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, me operatorët e rrjetit numerik, që kanë si objekt autorizimin e shfaqjes dhe shpërndarjes për veprat që administron; të përfaqësojë interesat e anëtarëve për shfrytëzimin e të drejtave, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke nënshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme;

të informojë, sipas kërkesës, mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave të tyre, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda kohës së parashikuar në statut;

të sigurojë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv, në lidhje me autoritetet publike të kontrollit sipas ligjit;

për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit dhe që u paguhet në formë shpërblimi mbajtësve të të drejtave ; paguan tatimin në burim, për shpërblimin e paguar tek mbajtësit e të të drejtave.

Agjencia përfaqëson ligjërisht duke përfaqësuar titullarët e të drejtave të autorit në Republikën e Shqipërisë sipas kontratave përkatëse apo të titullarëve të huaj të të drejtave të autorit, në përputhje me kontratat reciproke të lidhura me agjenci të huaja.

Në bazë të nenit 34 të Ligjit 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, nenit 133 të Ligjit 35 /2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të Tjera të Lidhura me to” për ushtrimin e aktivitetit shoqata duhet të aplikojë për

përfitimin e lejes përkatëse, pranë Ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, si kusht për ushtrimin të veprimtarisë e cila është subjekt lejeje.

Selia e Shoqatës është në adresën ***.

Kohëzgjatja e shoqatës është për një periudhë të pa kufizuar kohore.

Organet drejtuese të Shoqatës të parashikuara në nenin 7 janë : Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga: ***

Këshilli i Administrimit i cili përbëhet nga: Presidente ***, Zëvendës President (1) ***, Zëvendës President (2) ***, Sekretar i përgjithshëm ***, Financier ***.

Anëtarët themelues kanë miratuar dispozitat e statutit, duke përcaktuar kompetencat e organeve drejtuese të shoqatës respektivisht në nenin 8 e vijues të statutit.

Burimet e financimit të shoqatës të përcaktuara në statut janë financimi i saj nga ana e themeluesve në mënyrë të vazhdueshme përmes kuotizacioneve në masën e miratuar në statut, të ardhurat nga veprimtaria e Shoqatës, fonde dhe donacione të ndryshme të përfituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa sipër Gjykata vlerëson se dokumentacioni për regjistrimin e saj si person juridik është në përputhje me ligjin ,

PËR KETO ARSYE

Gjykata në bazë të Ligjit Nr.8788 datë 07.05.2001 “ Për organizatat jofitimprurëse”, Ligjit Nr.8789 datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” , Ligjit 35 /2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të Tjera të Lidhura me to”

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin si person juridik në regjistrin e Organizatave jofitimprurëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Shoqatës *** shkurtimisht *** me themelues -1.“ *** shoqëri e regjistruar që vepron sipas legjislacionit të Republikës së ***, me nr. unik identifikues ***, seli ***.

-2. ***. shoqëri e regjistruar që vepron sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë me nr. NUIS *** seli ***.

Shoqata është një organizatë e pavarur, joqeveritare, jopartiake, jofitimprurëse. Objekti i veprimtarisë së organizatës do të jetë :

Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, në përputhje me Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tij si dhe në përputhje me licensën përkatëse.

Agjencia ka si qëllim mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to dhe konkretisht administrimin kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramit, interesat e të cilëve Agjencia përfaqëson dhe me të cilët do të lidhë kontratat përkatëse.

Objekti i mesipërm do të përfshijë: dhënien për përdoruesit, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi; të mbledhë shpërblimin për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura; të shpëndaje, në bazë të rregullave të shpërndarjes, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit në mënyrë të drejtë dhe të përpjestuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura; të përfaqësojë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve ata administrojnë, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejnë çdo veprim tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ato; të kryejë çdo veprim tjetër, në përputhje me tagrat e tyre ligjore dhe të

organeve të veta vendimmarrëse, për kompetencat e marra nga mbajtësit e të drejtave; të hartojë metodologji të negociueshme për përcaktimin e nivelit të tarifave që subjektet përdoruese duhet të paguajnë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; të realizojë në emër të autorit ose të mbajtësit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të ose në bazë të kontratës së reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme marrëveshjet e përgjithshme me organizatorët e shfaqjeve, me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, me operatorët e rrjetit numerik, që kanë si objekt autorizimin e shfaqjes dhe shpërndarjes për veprat që administrojnë; të përfaqësojë interesat e anëtarëve për shfrytëzimin e të drejtave, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke nënshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme;

të informojë, sipas kërkesës, mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave të tyre, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda kohës së parashikuar në statut;

të sigurojë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv, në lidhje me autoritetet publike të kontrollit sipas ligjit;

për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit dhe që u paguhet në formë shperblimi mbajtesve te te drejtave ; paguan tatimin në burim, për shpërblimin e paguar tek mbajtësit e të të drejtave.

Agjencia përfaqëson ligjërisht duke përfaqësuar titullarët e të drejtave të autorit në Republikën e Shqipërisë sipas kontratave përkatëse apo të titullarëve të huaj të të drejtave të autorit, në përputhje me kontratat reciproke të lidhura me agjenci të huaja.

Në bazë të nenit 34 të Ligjit 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, nenit 133 të Ligjit 35 /2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të Tjera të Lidhura me to” për ushtrimin e aktivitetit shoqata duhet të aplikojë për përfitimin e lejes përkatëse, pranë Ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, si kusht për ushtrimin të veprimtarisë e cila është subjekt lejeje.

Selia e Shoqatës është në adresën ***.

Kohëzgjatja e shoqatës është për një periudhë të pa kufizuar kohore.

Organet drejtuese të Shoqates janë : Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga: ***.

Këshilli i Administrimit i cili përbëhet nga: Presidente ***, Zëvendës President (1) ***, Zëvendës President (2) ***, Sekretar i përgjithshëm *** Burimet e financimit të shoqatës të përcaktuara në statut janë financimi i saj nga ana e themeluesve në mënyrë të vazhdueshme përmes kuotizacioneve në masën e miratuar në statut, të ardhurat nga veprimtaria e Shoqatës, fonde dhe donacione të ndryshme të përfituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Tiranë më 22.01.2021.

GJYQTARE

MARIANA SHEGANI (DEDI)